

## **AMF: Paralajmërim për platformat mashtruese TXEX, XUEXA, GROKREXDUU dhe platforma të ngjashme**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në ushtrim të kompetencave të tij ligjore për mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe ruajtjen e integritetit të tregjeve nën mbikëqyrje, informon publikun mbi veprimtarinë e paligjshme të platformës TXEX, si dhe të platformave të ngjashme XUEXA dhe GROKREXDUU. **Këto subjekte nuk janë të licencuara apo të autorizuara nga AMF për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.**

Nga informacionet e siguruar rezultojnë se këto platforma paraqiten si aplikacione investimi që u ofrojnë përdoruesve të ashtuquajtura “sinjale blerjeje” për krypto-asete, duke krijuar përshtypjen tek investitorët se mund të ndikojnë mbi çmimet dhe të realizojnë përfitime. Ky mekanizëm në tërësinë e tij është fiktiv dhe nuk pasqyron veprime reale të kryera. Kjo veprimtari bie ndesh me legjislacionin në fuqi dhe përbën vepër mashtruese që cënon drejtpërdrejt interesat e investitorëve shqiptarë.

AMF, deri më sot, nuk ka licencuar apo autorizuar asnjë subjekt për të operuar në këto tregje në përputhje me Ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Lista e subjekteve të licencuara nga Autoriteti ndodhet në rubrikën “[Regjistri i të Licencuarve](#)” në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.